



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 5, paragrafi 3, pika 3.5 lidhur me nenin 24 të Ligji Nr.03/L-025, për Mbrojtjen e Mjedisit, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-50/2009” dhe konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Suharekës për periudhën 2025-2030

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunë e Suharekës për periudhën 2025-2030, me numër të protokollit 01-Nr-112-66232, i datës 04.12.2024, i hartuar nga grupi punues i themeluar me vendimin e Kryetarit të Komunës dhe nga ekspert të jashtëm të fushave të caktuara profesionale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

01-Nr-_____

Me datë_____